



BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVA
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

Anketa e Kreditimit Bankar në Kosovë

Numër 25

BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVA
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

Anketa e Kreditimit Bankar të Kosovës

(TM3 2025 dhe pritjet për TM4 2025)

Numër 25

BOTUES

© Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

Departamenti i Stabilitetit Financiar,
Hulumtimeve dhe Analizave Ekonomike

33 Garibaldi, Prishtinë 10000

Tel: +383 38 222 055

Fax: +383 38 243 763

Faqja e internetit

www.bqk-kos.org

Adresa elektronike

economic.analysis@bqk-kos.org

Përmbajtja

Anketa e Kreditimit Bankar në Kosovë (AKBK) -----	5
Hyrje -----	5
Përmbledhje-----	6
1.0 Kreditë ndaj ndërmarrjeve -----	7
1.1 Standardet kreditore -----	7
1.2 Kushtet dhe rregullat-----	8
1.3 Kërkesa për kredi-----	9
1.4 Cilësia kreditore-----	10
2.0 Kreditë ndaj ekonomive familjare -----	10
2.1 Standardet kreditore -----	10
2.2 Kushtet dhe rregullat-----	11
2.3 Kërkesa për kredi-----	11
2.4 Cilësia kreditore-----	12
3.0 Financimi-----	12
3.1 Përmbledhje e pyetjeve të fokusuara. -----	13
4.0 Përmbledhja e rezultateve për pritjet e inflacionit-----	14
Kutia 1. Metodologjia -----	15
Pritjet për inflacionin -----	16

Shkurtesat

AKBK – Anketa e Kreditimit Bankar të Kosovës

FKGK – Fondi Kosovar për Garanci Kreditore

NVM- Ndërmarrjet e vogla të mesme

Anketa e Kreditimit Bankar në Kosovë (AKBK)

Hyrje¹

Me qëllim parësor thellimin e kuptimit të dinamikave të kreditimit në Kosovë, Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (BQK) realizon anketë periodike me bankat komerciale që operojnë në tregun bankar në Kosovë. Si qëllim dytësor, anketa vlerëson pritjet e sektorit bankar lidhur me zhvillimet në nivelin e çmimeve të konsumit (inflacionit) në vend.

Raporti tremujor, që analizon rezultatet e këtij anketimi, ofron pasqyrë të gjerë dhe sistematike mbi perceptimin e rrezikut dhe gatishmërinë e bankave për të dhënë hua, si dhe mbi sjelljen e ekonomive familjare dhe ndërmarrjeve ndaj ndryshimeve në kushtet e kreditimit. Përveç pyetjeve standarde, anketa përfshinë edhe pyetje shtesë, të cilat sigurojnë informacion kualitativ për shpjegimin e dinamikave aktuale në sektorin bankar, si dhe për zberthimin e zhvillimeve të ofertës dhe kërkesës kreditore për ndërmarrjet sipas sektorëve ekonomik.

Ky edicion i raportit pasqyron sjelljen kreditore për tremujorin e tretë të vitit 2025, si dhe pritjet e bankave për dinamikat e kreditimit dhe inflacionin në tremujorin e katërt të vitit 2025.

¹ Për informata më të detajuara rreth qëllimit dhe historikut të anketës së kreditimit bankar në BQK, shikoni publikimin "Anketa e Kreditimit Bankar dhe Pritjeve të Inflacionit" Nr. 1.

Përmbledhje

Dinamikat e kreditimit bankar në tremujorin e tretë të vitit vazhduan të nxiten si nga kërkesa, ashtu edhe nga oferta kreditore, me këtë të fundit me ndikim dukshëm më të lartë. Oferta kreditore vazhdoi shtrëngimin deri në një masë si për segmentin e Ndërmarrjeve ashtu edhe për Ekonomitë Familjare. Në anën tjetër, kërkesa kreditore kishte zhvillime të ndryshme ndërmjet segmenteve. Për ekonomitë familjare, kërkesa mbeti kryesisht e pandryshuar, karakterizuar me rënie për kreditë personale/konsumuese. Ndërsa për segmentin e ndërmarrjeve, kishte rritje deri në një masë për NVM-të dhe kërkesë kryesisht të pandryshuar për ndërmarrjet e mëdha. Për tremujorin e katërt (TM4 2025), bankat presin lehtësim të standardeve kreditore për të dy segmentet. Kërkesa për kredi pritet të jetë më e lartë nga ndërmarrjet, ndërsa për ekonomitë familjare pritet të mbetet në nivele të ngjashme me tremujorin paraprak.

Për segmentin e ndërmarrjeve, **standardet kreditore** u shtrënguan deri në një masë për të dytin tremujor me radhë, me shtrëngim më të theksuar për ndërmarrjet e mëdha. Faktorët përcaktues në shtrëngim të kushteve dhe rregullave ishin toleranca më e ulët e bankave ndaj rrezikut, qasja në gjithsej financim dhe perceptimet lidhur me perspektivën ekonomike në tregun vendor. **Në kuadër të kushteve dhe rregullave të ofruara**, bankat deklaruan shtrëngim deri në një masë në normën e ofruar të interesit dhe madhësinë mesatare të kredisë, si për NVM-të ashtu edhe për ndërmarrjet e mëdha. **Niveli i aprovimit** të kredive ka shënuar rënie të lehtë kundrejt rritjes së shënuar në tremujorin paraprak. **Kërkesa për kredi** shënoi rritje deri në një masë, kryesisht si rezultat i kërkesës për financim prej NVM-ve, përkatësisht nevojës për financim të inventarit, kapitalit punues dhe investimeve fikse. **Cilësia e kredive** mbeti kryesisht e pandryshuar, kurse për tremujorin vijues pritet të ketë rritje të lehtë të nivelit të kredive jo-performuese. Në TM4 2025, bankat presin lehtësim deri në një masë të standardeve kreditore për ndërmarrjet, kurse kërkesa kreditore pritet të ketë rritje, e ndikuar nga nevoja për financim të inventarit, kapitalit punues dhe investimeve fikse.

Në linjë me pritjet e bankave nga anketa e kaluar, **standardet e përgjithshme kreditore për ekonomitë familjare** u shtrënguan deri në një masë për të dy segmentet - kreditë për blerje të shtëpive dhe kreditë personale/konsumuese. Faktorët kryesorë që ndikuan në shtrëngim ishin perceptimet lidhur me zhvillimet në tregun vendor, qasja në gjithsej financim, kufizimet në kapacitetin e bankave dhe toleranca më e ulët e bankës ndaj rrezikut. Në kuadër të **kushteve dhe rregullave të ofruara**, bankat raportuan shtrëngim deri në një masë në normat e interesit, si dhe shtrëngim – por në masë më të ulët - në madhësinë mesatare të kredisë dhe afatet e maturitetit. Niveli i aprovimit të kredive mbeti pothuajse i pandryshuar, me një rritje marginale krahasuar me tremujorin paraprak. **Kërkesa për kredi** mbeti përgjithësisht e pandryshuar, me rënie deri në një masë për kreditë personale/konsumuese, ndikuar kryesisht nga rënia e kërkesës për financim të shpenzimeve të tjera për konsum. **Cilësia e kredive** mbeti e pandryshuar, dhe pritet të mbetet e tillë edhe tremujorin në vijim. Për TM4 2025, **standardet kreditore** pritet të lehtësohen deri në një masë në përgjithësi, ndërsa kërkesa për kredi pritet të mbetet e pandryshuar, me tendencë të lehtë rënëse për kreditë për blerje të shtëpive (tabela 1).

Qasja në financim e bankave ka shënuar rritje gjatë TM3 2025, mbështetur kryesisht nga depozitat e ekonomive familjare dhe ato të korporatave jo-financiare. Po ashtu, rritje deri në një masë ka shënuar edhe financimi brenda grupit bankar. Në tremujorin në vijim, pritet rritje edhe më e lartë e qasjes në financim, kryesisht si rezultat i rritjes së depozitave nga ekonomitë familjare, korporatat jo-financiare dhe financimi nga institucionet financiare ndërkombëtare.

Tabela 1. Vlerësimi i bankave për ndryshimet në ofertën dhe kërkesën kreditore.

	Oferta (Standardet kreditore)		Kërkesa	
	TM3 2025	TM4 2025 (pritjet)	TM3 2025	TM4 2025 (pritjet)
Ndërmarrjet	↘	↗	↗	↗
NVM	↘	↗	↗	↗
Ndërmarrjet e mëdha	↘	↗	→	↗
Ekonomitë familjare	↘	↗	→	→
Kredi për blerjen e shtëpive	↘	↗	→	→
Kredi konsumuese	↘	↗	↘	→

↑	Lehtësim i standardeve kreditore/Rritje e kërkesës për kredi (indeks pozitiv mbi 0.20)
↗	Lehtësim i standardeve kreditore/Rritje e kërkesës për kredi (indeks pozitiv nën 0.20)
→	Kryesisht pandryshime (indeks pozitiv/negativ deri 0.05)
↘	Shtyrësim i standardeve kreditore/Rënie e kërkesës për kredi (indeks negativ nën 0.20)
↓	Shtyrësim i standardeve kreditore/Rënie e kërkesës për kredi (indeks negativ mbi 0.20)


Burimi: BQK.

1.0 Kreditë ndaj ndërmarrjeve

1.1 Standardet kreditore

Rezultatet e mesatarizuara të Anketës së Bankave për TM3 2025 (reflekojnë mesataren e peshuar në kreditim të secilës banke) tregojnë se standardet kreditore për segmentin e ndërmarrjeve vazhduan të shtrëngohen për të dytin tremujor me radhë, me efekt më të theksuar në segmentin e ndërmarrjeve të mëdha (Grafiku 1). Për NVM-të u raportua shtrëngim i standardeve kreditore nga dy banka, njëra nga të cilat bankë me rëndësi sistemike. Për ndërmarrjet e mëdha, kishte shtrëngim të standardeve nga tri banka, dy prej të cilave me rëndësi sistemike.


Grafiku 1. Standardet kreditore të aplikuara për ndërmarrjet



Burimi: BQK.

Faktorët kryesorë që ndikuan në shtrëngimin e standardeve kreditore në këtë periudhë ishin toleranca më e ulët e bankave ndaj rrezikut, qasja më e kufizuar në gjithsej burimet financuese, kufizimet në kapacitetin e bankave dhe perceptimet mbi perspektivën e tregut vendor. Mbështetja e vazhdueshme e FKGK-së vazhdoi të kontribuoj pozitivisht në ofertën kreditore bankare. Faktorët tjerë të cilët ndikuan pozitivisht në ofertën kreditore ishin edhe niveli i ulët i KJP-ve si dhe konkurrenca ndërbankare, por që u neutralizuan nga zhvillimet tjera në tregun bankar (Grafiku 2).

Grafik 2. Faktorët ndikues në standardet kreditore të aplikuara për ndërmarrjet




Burimi: BQK.

Për TM4 2025, bankat presin lehtësim të standardevë kreditore si për NVM-të ashtu edhe ndërmarrjet e mëdha. Në përgjithësi, shumica e faktorëve që ndikojnë në standardet kreditore pritet të kenë efekt pozitiv, ndërsa ndikimi i dy faktorëve të tjerë të cilët pritet të mbeten me efekt negativ – perspektiva për tregun vendor dhe toleranca ndaj rrezikut - do të zbuten, duke kontribuar gjithashtu në pritjet për përmirësimin e përgjithshëm të politikave të kreditimit (Grafik 2).

1.2 Kushtet dhe rregullat

Në TM3 2025, kushtet dhe rregullat e aplikuara për ndërmarrjet mbetën të shtrënguara në përgjithësi (Grafiku 3). Konkretisht, bankat raportuan shtrëngim në normën e interesit si për NVM-të, ashtu edhe për ndërmarrjet e mëdha, duke vijuar trendin e shtrëngimit të evidentuar edhe në dy tremujorët paraprak. Po ashtu, u raportua shtrëngim në madhësinë e kredisë për të dy segmentet e ndërmarrjeve. Ndërkaq, kushtet dhe rregullat e tjera të kreditimit - maturiteti i kredive, kërkesat për kolateral dhe tarifatat tjera - mbetën kryesisht të pandryshuara. Këto zhvillime reflektojnë deklaratimet e tri bankave, prej të cilave dy të rëndësishme sistemike.

Grafik 3. Kushtet dhe rregullat e aplikuara në standardet kreditore për ndërmarrjet



Burimi: BQK.

Faktorët kryesorë që ndikuan në kushtet dhe rregullat e kreditimit për segmentin e ndërmarrjeve ishin të njëjtë si për standardet kreditore. Në shtrëngim ndikuan kryesisht toleranca më e ulët ndaj rrezikut, kufizimet në kapacitetin e bankave, qasja në burimet e financimit dhe perspektiva e tregut vendor. Ndërkaq, faktorët me kontribut pozitiv ishin mbështetja e vazhdueshme nga FKGK, niveli i ulët i kredive jo-performuese dhe konkurrenca ndërbankare, por që efekti i tyre u neutralizua nga ndikimi i faktorëve me efekt shtrëngues. Në tremujorin vijues, kushtet dhe rregullat e aplikuara nga bankat pritet të mbesin kryesisht të pandryshuara si për NVM-të dhe ndërmarrjet e mëdha.


Në TM3 2025, niveli i aprovimit të kredive për ndërmarrjet shënoi rënie. Konkretisht kishte nivel më të ulët të aprovimeve për kreditë për ndërmarrjet e mëdha dhe me maturitet afatgjatë. Për NVM-

të kishite rritje të nivelit të aprovimit - kryesisht për kreditë me afat të shkurtër maturimi -, por dukshëm më të ulët krahasuar me tremujorin paraprak. *Për tremujorin vijues, niveli i aprovimit pritet të rritet deri në një masë si për NVM-të, ashtu edhe për ndërmarrjet e mëdha, si për kreditë me maturitet afatshkurtër ashtu edhe ato afatgjata.*

1.3 Kërkesa për kredi

Sipas rezultateve të anketës, kërkesa për kredi në TM3 2025 shënoi rritje, kryesisht si rezultat i kërkesës më të lartë prej NVM-ve, ndërsa kërkesa prej ndërmarrjeve të mëdha mbeti kryesisht e pandryshuar. Për NVM-të, bankat deklaruan rritje të kërkesës për kreditë me maturitet afatshkurtër si dhe afatgjatë. Këto dinamika pasqyrojnë përgjigjet e gjashtë bankave, tri prej të cilave të rëndësisë sistemike (Grafiku 4).

Grafiku 4. Kërkesa për kredi nga ndërmarrjet




Burimi: BQK.

Faktorët kryesorë që ndikuan pozitivisht kërkesën e përgjithshme për kredi nga ndërmarrjet këtë tremujor ishin nevoja për investime në inventar dhe kapital punues, si dhe për financim të investimeve fikse (Grafik 5).

Cilësia e aplikacioneve të pranuar nga ndërmarrjet shënoi rënie të lehtë, *por pritet të përmirësohet në tremujorin vijues – TM4 2025.*

Grafik 5. Faktorët që ndikuan kërkesën për kredi nga ndërmarrjet



Burimi: BQK.

Në TM4 2025, bankat presin rritje të kërkesës për kredi, si nga NVM-të ashtu edhe nga ndërmarrjet e mëdha, bazuar në deklaratimet e gjashtë bankave, të gjitha josistemike. Rritja e kërkesës pritet të jetë e pranishme për të dy kategoritë e ndërmarrjeve dhe për të gjitha maturitetet e kredisë. Kjo pritet të

ndikohet kryesisht nga nevoja për financim të inventarit dhe kapitalit punues, ndërsa kërkesa për investime fikse pritet të ketë ndikim më të kufizuar.

1.4 Cilësia kreditore


Bankat në përgjithësi raportuan për rritje, por në nivel të ulët, të kredive joperformuese për segmentin e ndërmarrjeve. *Për TM4 2025, pritet rritje e lehtë e KJP-ve krahasuar me tremujorin aktual.*

2.0 Kreditë ndaj ekonomive familjare

2.1 Standardet kreditore

Bazuar në rezultatet e mesatarizuara të Anketës së Kreditimit për TM3 2025, standardet kreditore të aplikuara në përgjithësi për ekonomitë familjare u shtrënguan deri në një masë, duke reflektuar vazhdimësinë e kushteve më konservatore të kreditimit për tremujorin e dytë me radhë (Grafiku 6). Për shtrëngim të standardeve kreditore, si për kreditë personale/konsumuese ashtu edhe për kreditë për blerje të shtëpive, u deklarua nga dy banka me rëndësi sistemike, ndërsa bankat tjera raportuan për standarde kreditore kryesisht të pandryshuara nga tremujori paraprak.


Grafiku 6. Standardet kreditore të aplikuara për ekonomitë familjare



Burimi: BQK.

Faktorët kryesorë që ndikuan në shtrëngim të standardeve kreditore ishin perspektiva e tregut vendor, qasja në gjithsej financim, kufizimet në kapacitetin e bankave dhe toleranca më e ulët e bankave ndaj rrezikut (Grafiku 7). Ndërkohë, në kahun lehtësues të standardeve kreditore ndikuan, por me efekt më të ulët, cilësia e mirë e portfolios kreditore dhe konkurrenca nga bankat e tjera.

Grafik 7. Faktorët ndikues në standardet kreditore të aplikuara për ekonomitë familjare



Burimi: BQK.


Për TM4 2025, pritet lehtësim deri në një masë i standardeve kreditore për ekonomitë familjare në përgjithësi, sipas deklaramit të një banke me rëndësi sistemike dhe një banke josistemike. Lehtësim pak

më i theksuar pritet të aplikohet në kreditë për blerje të shtëpive, krahasuar me ato personale/konsumuese. Faktorët që pritet të ndikojnë në lehtësimin e standardeve kreditore përfshijnë: pozicionin më të mirë me likuiditet, rritja e qasjes në gjithë burimet financuese, kualiteti i mirë i portfolios kreditore dhe pozicioni i kapitalit të bankave.

2.2 Kushtet dhe rregullat

Kushtet dhe rregullat e aplikuara për kreditë e reja ndaj ekonomive familjare u shtrënguan deri në një masë, si për kreditë për blerje të shtëpive ashtu dhe ato personale/konsumuese (Grafiku 8). Më konkretisht, në kuadër të kushteve dhe rregullave, dy banka me rëndësi sistemike deklaruan për shtrëngim në normën e interesit. Po ashtu, një bankë me rëndësi sistemike ka deklaruar për shtrëngim në madhësinë mesatare të kredisë dhe maturitetet. Faktorët që ndikuan në shtrëngim të kushteve dhe rregullave të aplikuara ishin perspektiva e tregut vendor, qasja në gjithë financim, dhe kufizimet në kapacitetin e bankave.

Grafik 8. Kushtet dhe rregullat e aplikuara në standardet kreditore për ekonomitë familjare



Burimi: BQK.


Për TM4 2025, bankat presin zhvillime të ndryshme në kushtet dhe rregullat e aplikuara për ekonomitë familjare, me lëvizje në të dy kahet. Më konkretisht, pritet shtrëngim në normën e interesit në kreditë për blerje të shtëpive, ndërkohë për ato personale/konsumuese normat e interesit pritet të mbesin kryesisht të pandryshuara. Në anën tjetër, pritet lehtësim në madhësinë mesatare të kredisë dhe maturitetet, për kreditë e të dy segmenteve.

Niveli i aprovimit të aplikacioneve për kredi nga ekonomitë familjare ka mbetur pothuajse i pandryshuar edhe gjatë këtij tremujori, me tendencë të lehtë në kahun pozitiv.

2.3 Kërkesa për kredi

Sipas rezultateve të mesatarizuara të anketës për TM3 2025, kërkesa e përgjithshme kreditore nga ekonomitë familjare mbeti kryesisht e pandryshuar, për dallim nga tremujori i kaluar, ku u evidentua shtim i kërkesës për kredi (Grafiku 9). Me rënie deri në një masë të kërkesës u karakterizuan kreditë personale/konsumuese, ndërsa për kreditë për blerje të shtëpive kërkesa mbeti kryesisht e pandryshuar.


Grafik 9. Kërkesa për kredi nga ekonomitë familjare



Burimi: BQK.

Rënia e kërkesës për financimin e shpenzimeve të tjera për konsum ishte faktori kryesor që ndikoi në rënie të kërkesës për kreditë personale/konsumuese. Po ashtu, perspektivat e tregut të patundshmërive dhe konfidenca e konsumatorit ndikuan deri në një masë negativisht në kërkesën e përgjithshme për kredi (Grafiku 10). *Për TM4 2025, kërkesa pritet të mbetet kryesisht e pandryshuar, me tendencë të lehtë rënëse për kreditë për blerje të shtëpive.*

Grafik 10. Faktorët që ndikuan kërkesën për kredi nga ekonomitë familjare



Burimi: BQK.

Cilësia e aplikacioneve të pranuar nga ekonomitë familjare ka mbetur e pandryshuar nga tremujori paraprak. *Po ashtu, për tremujorin vijues, pritet e bankave janë që cilësia e aplikacioneve të mbetet e njëjtë.*


2.4 Cilësia kreditore

Cilësia e portfolios kreditore për ekonomitë familjare mbeti e pandryshuar, në përputhje me pritjet e bankave nga tremujori i kaluar. *Po ashtu, në tremujorin vijues, cilësia e portfolios kreditore për ekonomitë familjare pritet të mbetet kryesisht e pandryshuar.*

3.0 Financimi

Në TM3 2025, qasja në financim e bankave ka shënuar rritje krahasuar me tremujorin e dytë të vitit, kur në përgjithësi nuk kishte ndryshim. Ky zhvillim u ndikua kryesisht nga depozitat e ekonomive familjare dhe ato të korporatave jofinanciare, të cilat shënuan rritje të konsiderueshme sipas deklarimit nga shumica e bankave. Për më tepër, për tremujorin e dytë radhazi, bankat deklaruan rritje të financimi brenda grupit. Sa i përket maturitetit, rritje ka shënuar si financimi afatgjatë, ashtu dhe ai afatshkurtër (Grafiku 11).

Grafik 11. Ndryshimi në financimin e e sektorit bankar



Burimi: BQK.

Në TM4 2025, pritet të ketë rritje akoma më të lartë të qasjes në financim, kryesisht si rezultat i rritjes së depozitave nga ekonomitë familjare, ndërsa depozitat e korporatave jofinanciare pritet të rriten, por me ritëm më të ngadalësuar. Në anën tjetër, financimi brenda grupit pritet të shënojë rënie, por që do të kompensohet nga rritja e financimit nga institucionet financiare ndërkombëtare.

3.1 Përmbledhje e pyetjeve të fokusuar

Pyetësi i anketës për TM3 2025 është pasuruar me dy pyetje shtesë, të cilat kanë për qëllim zgjerimin e përmbajtjes së anketës përtej pyetjeve standarde që lidhen me ofertën dhe kërkesën kreditore dhe faktorët ndikues mbi to. Bankat janë pyetur lidhur me mënyrën si kanë përshtatur qasjen e tyre dhe politikat e kreditimit në mënyrë që të sigurojnë pajtueshmëri me kërkesat makroprudenciale që vijnë nga harmonizimit i kornizës ligjore të BQK-se me atë të BE-së.

Në përgjigjet e dhëna rreth pyetjes së parë, në përgjithësi u theksua se ndryshimet në kërkesat për kapital nuk kanë sjellë nevojë për përshtatje të standardeve të kreditimit. Shumica e bankave, përfshirë të gjitha bankat me rëndësi sistemike, raportuan për qëndrueshmëri dhe mjaftueshmëri të kapitalit, që ka mundur rritjen pa pasur nevojë për ndryshime në politikat kreditore. Bankat theksuan se kanë qenë të përgatitura paraprakisht për këtë ndryshim, duke ruajtur rezerva të brendshme të kapitalit dhe duke planifikuar me kujdes rritjen e tij përmes fitimit të akumuluar apo instrumenteve të kapitalit të klasës së dytë. Në disa raste, bankat deklaruan se kanë ndërmarrë masa për optimizimin e portofolit kreditor, duke orientuar kreditimin drejt ekspozimeve me peshë më të ulët rreziku dhe duke forcuar proceset e vlerësimit të rrezikut dhe të kolateralit. Në përgjithësi, përgjigjet e bankave reflektojnë një qasje proaktive dhe të qëndrueshme ndaj menaxhimit të kapitalit, ku ndikimi i kërkesave të reja rregullative është adresuar kryesisht përmes planifikimit të brendshëm dhe ruajtjes së kapitalit shtesë, pa pasur nevojë për ndryshime në standardet e kreditimit.

Në përgjigjet e dhëna lidhur me pyetjen e dytë, bankat raportuan se qasja e tyre ndaj burimeve të financimit ka mbetur kryesisht e qëndrueshme, duke u mbështetur kryesisht në rritjen e depozitave si burim kryesor. Si rezultat, shumica nuk kanë raportuar nevojë për ndryshime të rëndësishme në politikat e kreditimit. Megjithatë, disa banka kanë përshtatur në nivel operacional kreditimin dhe menaxhimin rritjes së portofolit në linjë me rrjedhën e depozitave dhe likuiditetit, kostos së fondeve dhe strukturës së portofolit, për t'i dhënë prioritet sektorëve dhe klientëve me rrezik më të ulët dhe për t'u siguruar që politika kreditore përputhet me kapacitetin financiar dhe kapitalin e disponueshëm. Disa banka shtuan kujdes për shkak të rritjes së raportit kredi-depozita dhe ngadalësimit të rritjes së depozitave, duke monitoruar më afër strukturën e maturitetit dhe duke orientuar kreditimin drejt sektorëve me profil më të ulët rreziku. Në raste të

veçanta, banka siguruan burime shtesë financimi nga institucione financiare ndërkombëtare – përfshirë grupet bankare - për të ruajtur stabilitetin e likuiditetit dhe për të mbështetur rritjen e qëndrueshme të kreditimit.

Sa i përket përgjigjeve të disagreguara të bankave për ndërmarrjet sipas sektorëve ekonomik, standardet kreditore si dhe kushtet dhe rregullat e aplikuara mbetën kryesisht të pandryshuara, me një tendencë të lehtë shtrënguese në kushtet e ofruara për sektorin e ndërtimit. Ngjashëm me tremujorin e kaluar, kërkesa kreditore në TM3 2025 shënoi rritje pothuajse nga të gjithë sektorët ekonomik, me theks të veçantë për sektorin e pasurisë së paluajtshme banesore. *Në tremujorin vijues, standardet kreditore pritet të lehtësohen për sektorin e shërbimeve, kurse për sektorët tjerë kryesisht do të mbeten të pandryshuara. Ngjashëm, edhe kushtet dhe rregullat e aplikuara do të mbesin kryesisht të pandryshuara, me përjashtim për sektorin e ndërtimit që do të ketë shtrëngim deri në një masë. Kërkesa kreditore pritet të jetë dukshëm më e lartë, veçanërisht në sektorin e pasurisë së paluajtshme banesore, pasuar nga prodhimi dhe sektori i shërbimeve. Kërkesë në rritje pritet edhe për sektorin e ndërtimit, por më e ulët krahasuar me sektorët e tjerë ku pritet rritje.*

4.0 Përmbledhja e rezultateve për pritjet e inflacionit

Të dhënat nga anketa e tetorit 2025 tregojnë se bankat në përgjithësi presin që inflacioni gjatë pjesës së mbetur të vitit të mbetet rreth niveleve të njëjta me ato të tremujorit paraprak. Sipas vlerësimeve të tyre, norma e inflacionit pritet të sillet rreth 4.5 përqind në tremujorin e fundit të vitit 2025, ndërsa mesatarja vjetore pritet të jetë rreth 4.2 përqind (Tabela 2). Këto pritje vijojnë të pasqyrojnë rritje të presioneve inflacioniste krahasuar me vitin 2024 kur inflacioni mesatar ishte 1.6 përqind.

Tabela 2. Pritjet e inflacionit nga bankat, ndryshimi vjetor në përqindje

Bankat	TM3 2025	TM4 2025	2025
1	4.2%	4.4%	4.5%
2	4.5%	4.2%	4.0%
3	4.1%	4.2%	3.8%
4	4.7%	4.0%	3.5%
5	4.5%	4.8%	4.2%
6	4.7%	3.9%	3.9%
7	5.5%	5.5%	5.5%
8	4.7%	5.1%	3.8%
9	4.2%	3.6%	3.6%
10	4.7%	4.9%	4.9%
Mesatarja	4.6%	4.5%	4.2%


Burimi: Bankat komerciale dhe kalkuimet e BQK-së.

Grafiku 12 paraqet vlerësimin e bankave mbi probabilitetin e realizimit të niveleve të ndryshme të inflacionit. Rezultatet tregojnë një zhvendosje të pritjeve drejt niveleve më të larta të inflacionit. Krahasuar me anketën e tremujorit të dytë të vitit 2025, kur pritjet ishin kryesisht të përqendruara në intervalin 2.5–3.9%, ato tani janë zhvendosur drejt intervalit më të lartë prej 3.9–5.9%. Kjo zhvendosje është në përputhje me ecurinë e IHÇK, i cili është përsheptuar nga 3.6% në tremujorin e dytë të vitit 2025 në 4.5% në tremujorin e tretë.

Në përgjithësi, pritjet e bankave për ecurinë e inflacionit reflektojnë ndikimin e disa faktorëve kryesorë, të cilët kanë nxitur rritjen e çmimeve deri tani dhe pritet të vazhdojnë të ushtrorjnë presione inflacioniste. Sipas tyre, rritja e çmimeve të ushqimit, që përbën një pjesë të konsiderueshme të shportës së konsumit, ka qenë një nga nxitësit kryesorë të përsheptimit të inflacionit e që mund të vazhdojë të ndikojë edhe në periudhën në vijim.

Po ashtu, tarifat e rritura të energjisë elektrike dhe konsumi i rritur i energjisë elektrike në sezonin dimëror pritet të vazhdojnë të ushqejnë presionet inflacioniste. Bankat vlerësojnë se çmimet e shërbimeve po ashtu kanë kontribuar në përshpejtim të inflacionit dhe pritet të vazhdojnë këtë ndikim edhe në muajt e ardhshëm. Përveç faktorëve të brendshëm, vlerësohet se ndikimet e jashtme, përfshirë tensionet gjeopolitike dhe pasiguritë lidhur me çmimet e mallrave në tregjet ndërkombëtare, mbeten burime të rëndësishme pasigurie për ecurinë e inflacionit në muajt e ardhshëm.

Grafik 12. Probabiliteti i inflacionit për tremujorin e ardhshëm (boshti-x: pritjet e inflacionit, ndryshimi vjetor në përqindje; boshti-y: probabiliteti)



Burimi: Bankat komerciale dhe kalkulimet e BQK-së.

Në përgjithësi, bankat presin që inflacioni në tremujorin e katërt të vitit 2025 të qëndrojë afërsisht në të njëjtin nivel me TM3 2025 (rreth 4.5 përqind), duke reflektuar tendencën rritëse të IHÇK-së. Megjithatë, pritjet e tyre për inflacionin vjetor (4.2 përqind) tejkalojnë mesataren vjetore deri në shtator, e cila rezultoi 3.4 përqind, dhe janë më të larta se sa do të pritej duke pasur parasysh nivelin më të ulët të inflacionit në gjysmën e parë të vitit.

Kutia 1. Metodologjia

Pyetëtori i Anketës së Kreditimit Bankar në Kosovë

Pyetëtori i AKBK është i bazuar në forma të standardizuara të pyetësorëve të përdorur nga Bankat Qendrore të vendeve të eurozonës dhe më gjerë. Megjithatë, pyetëtori i BQK për AKBK është modifikuar dhe përshtatur që në mënyrën më të mirë dhe më gjithëpërfshirëse të paraqet zhvillimet e kreditimit në sektorin bankar në Kosovë.

Pyetëtori i AKBK përbëhet nga 19 pyetje, të cilat mbulojnë ndryshimet në ofertën dhe kërkesën për kredi, faktorët që kontribuojnë në këto ndryshime si dhe qasjen në financim të sektorit bankar, në baza tre mujore. Pyetjet mbi kreditimin bankar fokusohen në dy kategori kryesore: (i) kreditë ndaj ndërmarrjeve, dhe (ii) kreditë ndaj ekonomive familjare. Për më tepër, kreditë ndaj ndërmarrjeve nën-kategorizohen në kreditë ndaj NVM-ve dhe kreditë ndaj ndërmarrjeve të mëdha, përderisa kreditë ndaj ekonomive familjare nën-kategorizohen në kreditë për blerjen e shtëpive dhe kreditë personale/konsumuese. Për të gjitha kategoritë e lartpërmendura, ndryshimet në ofertën kreditore përcaktohen nga standardet kreditore të aplikuara gjatë aprovimit të kredive, kushtet dhe rregullat e aplikuara për kreditë e reja, norma e aprovimit të kredive, si dhe faktorët që ndikojnë në ndryshimet e tyre. Ndërsa, ndryshimet në kërkesën për kredi përcaktohen nga kërkesa për kredi (numri i aplikacioneve për kredi), cilësia e aplikacioneve të pranuar për kredi, si dhe faktorët që e ndikojnë kërkesën për kredi. Pyetjet e anketës kryesisht janë të formuluar për ndryshimet gjatë tre muajve paraprak dhe pritjet për tre muajt e ardhshëm. Gjithashtu, pyetjet mbulojnë kreditë edhe në aspekt të maturimit të tyre dhe valutës në të cilën lëshohen. Përveç pyetjeve standarde, pyetëtori i AKBK mund të përmbajë edhe pyetje shtesë mbi çështje specifike me interes për shpjegimin e zhvillimeve në sektorin bankar. Përderisa pyetjet standarde mbulojnë një periudhë tre-mujore, pyetjet shtesë mund t'i referohen ndryshimeve gjatë një periudhe kohore më të gjatë. Në anketim marrin pjesë dhjetë nga dhjetë bankat që operojnë në Kosovë. Rrjedhimisht, bankat pjesëmarrëse përfaqësojnë tregun e përgjithshëm bankar dhe sigurojnë një përfaqësim të duhur statistikor, duke marrë parasysh se përfaqësojnë rreth 98 përqind të aseteve të gjithsej sektorit bankar dhe 99.1 përqind të gjithsej kreditimit në sektorin bankar. Pjesëmarrësve të anketës u kërkohet të tregojnë në mënyrë cilësore forcën e çdo shtrëngimi ose lehtësimi apo forcën e çdo ulje ose rritje, duke raportuar ndryshimet përmes pesë shkallëve si: (i) shtrënguar / ulur në mënyrë të konsiderueshme, (ii) shtrënguar / ulur në një masë, (iii) e pandryshuar, (iv) lehtësuar / rritur në një masë ose (v) lehtësuar / rritur në mënyrë të konsiderueshme.

Gjenerimi i rezultateve të anketës së kreditimit bankar

Kuantifikimi i përgjigjeve të marra nga bankat individuale dhe agregimi i tyre për të paraqitur ndryshimet në nivel sektori arrihet përmes gjenerimit të një indeksi. Ky indeks gjenerohet për çdo kategori e nën-kategori të secilës pyetje, duke dhënë në këtë mënyrë një njësi kuantifikuese për përgjigjet e marra në nivel të sektorit. Fillimisht, përgjigjeve u përcaktohet një vlerë në bazë të forcës së ndryshimeve, konkretisht përgjigjeve ku bankat kanë deklaruar shtrëngim/ulje të konsiderueshme u përcaktohet vlera - 1, vlerë dyfish më e madhe se ajo e përcaktuar për përgjigjet kur bankat deklarojnë shtrëngim / ulje deri në një masë (vlerë prej -0.5). Ngjashëm, përgjigjet kur kemi lehtësim/rritje të konsiderueshme kanë vlerë 1, përderisa ato me lehtësim/rritje deri në një masë u përcaktohet vlera 0.5. Rezultatet po ashtu janë të peshuara në bazë të peshës që secila prej bankave ka në gjithësej kreditimin e sektorit bankar. Përfundimisht, pesha e secilës bankë sipas pjesëmarrjes në tregun e kredive shumëzohet me vlerën e përcaktuar në bazë të intensitetit të përgjigjes së dhënë, duke fituar indeksin në fjalë. Më tutje, agregimi i indeksit në nivel sektori bëhet përmes shumës së indekseve të fituara për secilën bankë. Vlerat e indeksit janë në mes të -1 dhe 1, ku vlerat pozitive të indeksit paraqesin lehtësim, rritje apo kontribut pozitiv dhe në kontrast vlerat negative paraqesin shtrëngim, rënie apo kontribut negativ.

Pritjet për inflacionin

Pritjet e inflacionit luajnë të paktën dy role të rëndësishme. Së pari, ato ofrojnë një statistikë përmbledhëse kuantifikuese për shkallën e inflacionit në të ardhmen, dhe së dyti, mund të përdoren për të vlerësuar besueshmërinë e objektivit të inflacionit të vendosur nga bankat qendrore. Rëndësia e pritjeve të inflacionit është më e madhe për vendet që kanë adoptuar strategjinë e shënjestrimit të inflacionit. Për këto vende, pritjet e inflacionit, shërbejnë gjithashtu si një tregues i besueshmërisë së publikut ndaj bankës qendrore. Nëse publiku beson se banka qendrore do të ndër marrë veprimet e nevojshme për të arritur objektivin e inflacionit, atëherë pritjet e agjentëve ekonomik për shkallën e inflacionit do të jenë më të afërta me objektivin e përcaktuar.

Pritjet e inflacionit janë gjithashtu të rëndësishme për bankat që nuk posedojnë politikë monetare, pasi ato shërbejnë si input i rëndësishëm për përcaktimin e çmimeve dhe pagave, si dhe për procesin e modelimit dhe parashikimit ekonomik. Për më tepër, pritjet e inflacionit ndikojnë në kërkesën agregate, e cila më pas ndikon në ecurinë e inflacionit.

Për dallim nga inflacioni aktual, i cili matet në mënyrë të drejtpërdrejtë, pritjet lidhur me inflacionin vlerësohen me metoda të tërthorta. Një prej metodave më të përdorura është anketimi i agjentëve ekonomikë: konsumatorëve, bizneseve, bankave komerciale, etj. BQK, për herë të parë, ka filluar vlerësimin e pritjeve për inflacionin në tremujorin e tretë të vitit 2019, fillimisht me bankat komerciale.

Vlerësimet që merren nga bankat komerciale janë të formës sasiore dhe shoqërohen me shpërndarje të probabilitetit. Pritjet për inflacionin vlerësohen për horizonte të ndryshme kohore: fillimisht për tremujorin aktual, pastaj për tremujorin e ardhshëm dhe për vitin në përgjithësi. Mbledhja e informacionit përmes anketave pasohet nga procesi i sistemimit, përpunimit dhe agregimit të të dhënave për të gjetur mesataren e pritjeve të inflacionit nga bankat komerciale.



Rr. Garibaldi, nr.33, 10000 Prishtinë,
Republika e Kosovës
Tel: +383 38 222 055; Fax: +383 38 243 763
Web: www.bqk-kos.org